

Në bazë të nenit 28 paragrafi (2), nenit 30 paragrafi (1) dhe nenit 45 paragrafi (1) pika (1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe nr. 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës në përbërje: Mr. Borçe Razmoski – Kryetar, Mr. Malinka Siljanovska Nikoliq, Aleksandar Trgačevski, Nikolla Trajčevski dhe Valon Elezi - anëtarë, duke vepruar në procedurën e iniciuar sipas detyrës zyrtare me konkluzionin PK nr. 09-17/1 të datës 07.02.2025 kundër personit fizik Erxhan Sullkoski, XXX i përfaqësuar nga Gjorgji Donovski, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 27.08.2025 e solli këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se personi fizik Erxhan Sullkoski, XXX i përfaqësuar nga Gjorgji Donovski, avokat nga Shkupi, edhe pse në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ishte i detyruar që në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës të dorëzojë njoftim për përqendrim para zbatimit të tij, gjegjësisht para parashtimit të fletëparaqitjes për ndryshim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 23.08.2022, ndërsa pas lidhjes së Marrëveshjes për bartjen e pjesës të datës 16.08.2022, i njëjti në periudhën e theksuar nuk ka parashtuar njoftim për përqendrim, me çka ka kryer Kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit, për çka personit fizik Erxhan Sullkoski, me adresë banimi XXX i shqiptohet sanksion - gjobë në shumë prej 307.000 denarë që paraqet XXX% të vlerës së të ardhurave të përgjithshme vjetore të personit fizik Erxhan Sullkoski (të llogaritura në pajtim me nenin 16 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës) të realizuar në vitin 2021 si vit që i paraprin përqendrimit.

2. Konstatohet se personi fizik Erxhan Sullkoski, XXX, i përfaqësuar nga Gjorgji Donovski, avokat nga Shkupi, edhe pse në përputhje me nenin 18 paragrafi (1) të Ligjit nuk guxonte ta zbatonte përqendrimin para datës 16.07.2025, si ditë kur Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës solli vendim me të cilin konstatohet se përqendrimi në fjalë është në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, personi fizik Erxhan Sullkoski XXX e ka zbatuar përqendrimin më datë 23.08.2022 me parashtimin e fletëparaqitjes për ndryshim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me çka ka kryer Kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, për çka personit fizik Erxhan Sullkoski, XXX i shqiptohet sanksion - gjobë në shumë prej 2.152.000 denarë që paraqet XXX% të vlerës së të ardhurave të përgjithshme vjetore të personit fizik Erxhan Sullkoski, XXX (të llogaritura në pajtim me nenin 16 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës) të realizuar në vitin 2021 si vit që i paraprin përqendrimit.

3. Për Kundërvajtjet nga pika 1) dhe 2) të këtij vendimi personit fizik Konstatohet se personit fizik Erxhan Sullkoski, me adresë banimi XXX, i përfaqësuar nga Gjorgji Donovski, avokat nga Shkupi, i shqiptohet sanksion unik-gjobë në shumë prej 2.459.000 denarë, që paraqet XXX% të vlerës së të ardhurave të përgjithshme vjetore të personit fizik Erxhan Sullkoski, me adresë banimi XXX, (të llogaritura në pajtim me nenin 16 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës) të realizuar në vitin 2021 si vit që i paraprin përqendrimit.

4. Gjobën nga pika 3) të këtij vendimi, kryerësi i Kundërvajtjes është i detyruar ta paguajë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit në llogarinë e transaksionit të

pranuesit të urdhëresës: 100-0000000630-95, llogaria e pagesës: 840xxx¹07337 - gjoba për Kundërvajtje të kryera nga fusha në kompetencë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, me shifër të të hyrave 722139 dhe program 00, pranues i urdhëresës – Ministria e Financave, banka e pranuesit – BPRMV dhe në Komisionin për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të dorëzojë dëshmi/kopje të pagesës së kryer të gjobës në afat prej 15 ditësh nga pagesa e kryer. Gjoba e papaguar ose gjoba e papaguar në kohë, do të arkëtohet në rrugë të detyrueshme. Padia e shtyn ekzekutimin e vendimit.

A r s y e t i m

Kryetari i Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: KVK) si raportues për lëndën 09-5 të vitit 2024 më datë 04.10.2024 dorëzoi shkresë nr. 09-42/1 deri te KVK me qëllim që KVK të konstatojë nëse eventualisht është kryer Kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 1) dhe/ose 60 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

KVK më datë 07.02.2025 sipas detyrës zyrtare solli konkluzion PK nr. 09-17/1 për iniciimin e procedurës për Kundërvajtje kundër Erxhan Sullkoski, XXX për shkak të mosparashtrimit të njoftimit për përqendrim në pajtim me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, që paraqet Kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe për shkak të zbatimit të përqendrimit në kundërshtim me nenin 18 paragrafi (1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, që paraqet Kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Me konkluzionin për iniciimin e procedurës për Kundërvajtje KVK e obligoi Erxhan Sullkoskin, në pajtim me nenin 40 të Ligjit, të dorëzojë:

-të dhënë për të ardhurat e përgjithshme të realizuara të Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup me seli në rr. Stoltenbergova nr. 4-k.5./2 Shkup në vitin 2021, të llogaritura në pajtim me nenin 16 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës

-të dhënë për të ardhurat e përgjithshme të realizuara të Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup me seli në rr. Stoltenbergova nr. 4-k.5./2 Shkup në vitin 2021 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të llogaritura në pajtim me nenin 16 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës,

-të dhënë për të ardhurat e përgjithshme të realizuara të Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime PACIFIK PETROLEUM import-eksport SHPKNJP Shkup me seli në rr. Dane Krapçev nr. 12 Shkup, në vitin 2021, të llogaritura në pajtim me nenin 16 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe

-të dhënë për të ardhurat e përgjithshme të realizuara të Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime PACIFIK PETROLEUM import-eksport SHPKNJP Shkup me seli në rr. Dane Krapçev nr. 12 Shkup, në vitin 2021 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të llogaritura në pajtim me nenin 16 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës,

Konkluzioni i theksuar është dorëzuar me letër përcjellëse PK nr. 09-17/2 të datës 07.02.2025.

¹ Shënohet shenja e komunës në pajtim me Listën e komunave me shenja në Republikën e Maqedonisë, e cila është pjesë përbërëse e Udhëzimit për mënyrën e evidentimit, shpërndarjes dhe kthimit të të ardhurave publike (Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 8/06).

Me shkresën tonë PK nr. 09-17/3 të datës 20.02.2025 Erxhan Sullkoski u përgjigj në konkluzionin e theksuar.

Më datë 04.04.2025 KVK solli Njoftim preliminar për gjendjen faktike të konstatuar PK nr. 09-17/4 dhe e dorëzoi me shkresë PK nr. 09-17/5 të datës 04.04.2025.

Shermie Sullkoska dorëzoi shkresë deri te KVK e jona PK nr. 09-17/6 të datës 25.04.2025.

KVK më datë 28.04.2025 me Shkresë PK nr. 09-17/7 dorëzoi Njoftim preliminar.

Gjykata Themelore Penale Shkup dorëzoi shkresë e jona PK nr. 09-17/8 të datës 07.05.2025.

Me shkresë PK nr. 09-12/10 të datës 22.07.2025 Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës dorëzoi njoftim deri te KVK.

Më datë 25.07.2025 KVK solli Njoftim përfundimtar për gjendjen faktike të konstatuar PK nr. 09-17/9 dhe e dorëzoi me shkresë PK nr. 09-17/10 të datës 25.07.2025.

Më datë 01.08.2025 me shkresë (E jona nr. 09-17/11) Erxhan Sullkoski dorëzoi Deklarim.

Më datë 15.08.2025 me shkresë (E jona nr. 09-17/12) Erxhan Sullkoski dorëzoi plotësim të deklaramit.

Në bazë të analizës së të dhënave dhe dokumenteve të dorëzuara KVK në procedurën e deritanishme për lëndën, konstatoi gjendjen faktike si vijon:

Kryetari i Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: KVK) si raportues për lëndën 09-5 të vitit 2024 më datë 04.10.2024 dorëzoi shkresë nr. 09-42/1 deri te KVK me qëllim që KVK të konstatojë nëse eventualisht është kryer Kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 1) dhe/ose 60 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit. Në shkresë theksohet se më datë 29.01.2024 me shkresë 12-462/59 të datës 28.12.2023 (Numri ynë 09-5/1 i datës 29.01.2024) nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) deri te Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar shkresë – Iniciativë. Në shtojcë të shkresës, janë dorëzuar edhe vendimi i KSHPK-së i datës 27.12.2023 për lëndën nr. 12-462/1 si dhe Iniciativë për përcaktimin e përgjegjësisë, sipas vendimit të sjellë të KSHPK-së 12-462/54 të datës 27.12.2023.

Nga Iniciativa e dorëzuar për përcaktimin e përgjegjësisë shihet se personi fizik Erxhan Sullkoski, XXX i është qasur strukturës themeluese dhe ka fituar kontroll mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup (RKM SHPK Shkup) me seli në rr. Stoltenbergova nr. 4-k.5./2 Shkup me çka ka ndodhur përqendrim për të cilin ka ekzistuar detyrim të dorëzohet njoftim deri te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe se sipas të dhënave nga Historiku i ndryshimeve për Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup më datë 23.08.2022 në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut është parashtruar fletëparaqitje për ndryshim, mes tjerash edhe të themeluesve, kryegjësë themelore dhe të Aktit për themelim, pas çka personi fizik Erxhan Sullkoski, XXX me kontribut në para ka fituar 65% të pjesëve në Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup, me çka ka fituar kontroll mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK

Shkup, si dhe se Erxhan Sullkoski është ortak i vetëm në Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime PACIFIK PETROLEUM import-eksport SHPKNJP Shkup me seli në rr. Dane Krapçev nr. 12 Shkup, që shihet nga Gjendja aktuale për shoqërinë e theksuar.

Krijimi i përqendrimit

Në përputhje me nenin 12 paragrafi (1) pika 2) alineja 2 të Ligjit, përqendrimi krijohet me ndryshimin e kontrollit në bazë afatgjate, ndërsa veçanërisht si rezultat i fitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të tërësisë ose pjesëve të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera nga një ose më shumë persona të cilët tashmë kontrollojnë së paku një ndërmarrje.

Më datë 16.08.2022 kanë lidhur Marrëveshje për bartjen e pjesës (kuotës) sipas së cilës personi Ratko Kapushevski nga Shkupi XXX në cilësinë e bartësit të pjesës i bart 65% të pjesës në Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup pranuesit të pjesës, personit Erxhan Sullkoski XXX.

Sipas të dhënave nga Historiku i ndryshimeve për Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup më datë 23.08.2022 në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut është parashtruar fletëparaqitje për ndryshim, mes tjerash edhe të themeluesve, kryegjësë themelore dhe të Aktit për themelim, pas çka personi fizik Erxhan Sullkoski, XXX me kontribut në para ka fituar 65% të pjesëve në Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup, me çka ka fituar kontroll të plotë mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup.

Erxhan Sullkoski është ortak i vetëm në Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime PACIFIK PETROLEUM import-eksport SHPKNJP Shkup me seli në XXX, që shihet nga Gjendja aktuale për shoqërinë e theksuar.

Nga e theksuara është e qartë se në përputhje me nenin 12 paragrafi (1) pika 2) alineja 2 të Ligjit, është krijuar përqendrim me ndryshimin e kontrollit në bazë afatgjate, si rezultat i fitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup nga personi – Erxhan Sullkoski, XXX, i cili tashmë kontrollon së paku një ndërmarrje - Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime PACIFIK PETROLEUM import-eksport SHPKNJP Shkup me seli në rr. Dane Krapçev nr. 12 Shkup.

Kushtet për njoftim për përqendrim

Në përputhje me nenin 14 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit, njoftim për përqendrim dorëzohet në Komision nëse e ardhura e përgjithshme e përbashkët vjetore e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse në përqendrim e realizuar me shitjen e mallrave dhe shërbimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut e tejkalon shumën prej 2,5 milionë euro në kundërvlerë në denarë.

- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime PACIFIK PETROLEUM import-eksport SHPKNJP Shkup në vitin 2021 ka realizuar të ardhura të përgjithshme në shumë prej XXX denarë, gjegjësisht XXX euro². Të gjitha të ardhurat e theksuara shoqëria i ka realizuar me shitjen e mallrave dhe shërbimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup në vitin 2021 ka realizuar të ardhura të përgjithshme në shumë prej XXX denarë, gjegjësisht XXX euro,

² Kursi mesatar i këmbimit të BPRMV më 31.12.2021 1 euro = 61.6270 denarë

ndërsa në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka realizuar të ardhura të përgjithshme prej XXX denarë gjegjësisht XXX euro.

Nga të dhënat e theksuara shihet se e ardhura e përgjithshme e përbashkët vjetore e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse në përqendrim e realizuar me shitjen e mallrave dhe shërbimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut e tejkalon shumë prej 2,5 milionë euro në kundërvlerë në denarë, andaj këtu është përmbushur kushti nga neni 14 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 15 paragrafi (1) të Ligjit pjesëmarrësit në përqendrim janë të detyruar që në Komision të dorëzojnë njoftim për përqendrim para zbatimit të tij, ndërsa pas lidhjes së marrëveshjes. Në pajtim me nenin 15 paragrafi (3) të Ligjit, njoftim për përqendrim parashtrohet personi, gjegjësisht ndërmarrja e cila fiton kontroll mbi tërësinë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve. Në rastin konkret është e pakontestueshme se ka ekzistuar detyrim për personin fizik Erxhan Sullkoski të dorëzojë njoftim për përqendrim në Komision pas lidhjes së Marrëveshjes për bartjen e pjesës të datës 16.08.2022 ndërsa para zbatimit të së njëjtës.

Zbatimi i përqendrimit, në rastin konkret, ka ndodhur me parashtimin e fletëparaqitjes për ndryshim, mes tjerash edhe të themeluesve, kryegjësë themelore dhe të Aktit për themelim, në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 23.08.2022.

Prandaj, personi fizik Erxhan Sullkoski, si person i cili ka fituar kontroll mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup, edhe pse në pajtim me nenin 15 të Ligjit ishte i detyruar që në Komision të dorëzojë njoftim për përqendrim pas lidhjes së Marrëveshjes për bartjen e pjesës të datës 16.08.2022, ndërsa para zbatimit të saj gjegjësisht para datës 23.08.2022, i njëjti nuk ka parashtuar njoftim për përqendrim në periudhën e theksuar, me çka ka kryer Kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit.

Personi fizik Erxhan Sullkoski njoftim të plotë për përqendrimin e theksuar në Komision e ka dorëzuar më datë 03.07.2025. Në pajtim me nenin 60 paragrafi (1) të Ligjit Për Kundërvajtjen e kryer, nga neni 60 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit, personit fizik Erxhan Sullkoski do t'i shqiptohet sanksion për Kundërvajtje – gjobë në shumë deri në 10% të vlerës së të ardhurave të përgjithshme vjetore të realizuara në vitin afarist që i paraprin përqendrimit të llogaritur në pajtim me nenin 16 të Ligjit, *gjegjësisht të ardhurave të përgjithshme që përbëhen nga shumat e realizuara me shitjen e mallrave të prodhuara në punën e rregullt të ndërmarrjes, si dhe nga shumat nga shërbimet që ndërmarrja i jep në punën e saj të rregullt, ndërsa të realizuara në vitin afarist që i paraprin përqendrimit, pas zbritjes së rabateve (zbritjeve) të shitjes dhe tatimit mbi vlerën e shtuar dhe detyrimeve të tjera publike të lidhura drejtpërdrejt me të ardhurat. Nëse njëri nga pjesëmarrësit është ndërmarrje e lidhur në kuptim të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjatë llogaritjes së të ardhurave të saj të përgjithshme, të gjitha ndërmarrjet që janë të lidhura në atë mënyrë do të trajtohen si një ndërmarrje, me ç'rast kur llogariten të ardhurat e përgjithshme të ndërmarrjeve të lidhura nuk do të merren parasysh shumat e realizuara nga shitjet e mallrave dhe/ose dhënia e shërbimeve midis tyre.*

Të ardhurat e përgjithshme të personit fizik Erxhan Sullkoski të realizuara në vitin 2021 (të llogaritura në pajtim me nenin 16 të Ligjit) si vit që i paraprin përqendrimit arrijnë në XXX denarë, gjegjësisht XXX euro.

Në përcaktimin e shumës së gjobës, në pajtim me nenin 64 të Ligjit, KVK merr parasysh peshën e Kundërvajtjes, kohëzgjatjen e Kundërvajtjes dhe shkallën e shtrembërimit të konkurrencës dhe pasojat e shkaktuara nga kundërvajtja.

Gjatë matjes së gjobës KVK merr parasysh rrethanat lehtësuese vijuese:

- Komisioni me vendimin nr. 08-87 të datës 16.07.2025, konstatoi se përqendrimi i theksuar është në përputhje me dispozitat e Ligjit, andaj këtej me zbatimin e përqendrimit nuk është shtrembëruar konkurrenca dhe nuk janë shkaktuar pasoja për konkurrencën në tregun relevant;
- personi fizik Erxhan Sullkoski vullnetarisht e informoi Komisionin për përqendrimin duke parashtruar njoftim për përqendrim nr. 08-87 të datës 16.05.2025, ndërsa të plotësuar më 05.06.2025, 23.06.2025 dhe më 03.07.2025 dhe

personi fizik Erxhan Sullkoski bashkëpunoi në mënyrë efektive me KVK-në gjatë kohës së procedurës.

Në bazë të asaj që u tha më lart KVK konstatoi se personi fizik Erxhan Sullkoski si person i cili ka fituar kontroll mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup, edhe pse në pajtim me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ishte i detyruar që në Komision të dorëzojë njoftim për përqendrim para zbatimit të tij gjegjësisht para parashtrimit të fletëparaqitjes për ndryshim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 23.08.2022, ndërsa pas lidhjes së Marrëveshjes për bartjen e pjesës të datës 16.08.2022, i njëjti në periudhën e theksuar nuk ka parashtruar njoftim për përqendrim, me çka ka kryer Kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për çka i shqiptohet sanksion - gjobë në shumë prej 307.000 denarë që paraqet XXX% të vlerës së të ardhurave të përgjithshme vjetore të personit fizik Erxhan Sullkoski (të llogaritura në pajtim me nenin 16 të Ligjit) të realizuar në vitin 2021 si vit që i paraprin përqendrimit.

Në përputhje me nenin 18 paragrafi (1) të Ligjit, përqendrimi nuk guxon të zbatohet as para se të jetë parashtruar njoftim për të njëjtin në Komision, as pas parashtrimit të njoftimit, derisa të mos sillet vendim se përqendrimi është në përputhje me dispozitat e Ligjit. KVK konstatoi se përqendrimi është zbatuar pa u parashtruar njoftimi në Komision dhe pa u sjellë vendim nga Komisioni, gjegjësisht Erxhan Sullkoski ka vepruar në kundërshtim me nenin 18 paragrafi (1) të Ligjit.

Zbatimi i përqendrimit në kundërshtim me nenin 18 paragrafi (1) të Ligjit paraqet Kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

KVK konstatoi se kohëzgjatja e Kundërvajtjes nga neni 60 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit është nga data 23.08.2022 si ditë kur është parashtruar fletëparaqitja për ndryshim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut deri më datë 16.07.2025, si ditë kur është sjellë vendim me të cilin konstatohet se përqendrimi lëndor është në përputhje me Ligjin. Në bazë të kësaj periudha në të cilën ka zgjatur kundërvajtja arrin në 2 vjet e 11 muaj.

Në përputhje me nenin 60 paragrafi (1) të Ligjit, për Kundërvajtjen e kryer nga neni 60 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit, Erxhan Sullkoskit do t'i shqiptohet sanksion për Kundërvajtje – gjobë në shumë deri në 10% të vlerës së të ardhurave të përgjithshme vjetore të realizuara në vitin afarist që i paraprin përqendrimit të llogaritur në pajtim me nenin 16 të Ligjit, *gjegjësisht të ardhurave të përgjithshme që përbëhen nga shumat e realizuara me shitjen e mallrave të prodhuara në punën e rregullt të ndërmarrjes, si dhe nga shumat nga shërbimet që ndërmarrja i jep në punën e saj të rregullt, ndërsa të realizuara në vitin afarist që i paraprin përqendrimit,*

pas zbritjes së rabateve (zbritjeve) të shitjes dhe tatimit mbi vlerën e shtuar dhe detyrimeve të tjera publike të lidhura drejtpërdrejt me të ardhurat. Nëse njëri nga pjesëmarrësit është ndërmarrje e lidhur në kuptim të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjatë llogaritjes së të ardhurave të saj të përgjithshme, të gjitha ndërmarrjet që janë të lidhura në atë mënyrë do të trajtohen si një ndërmarrje, me ç'rast kur llogariten të ardhurat e përgjithshme të ndërmarrjeve të lidhura nuk do të merren parasysh shumat e realizuara nga shitjet e mallrave dhe/ose dhënia e shërbimeve midis tyre.

Të ardhurat e përgjithshme të personit fizik Erxhan Sullkoski të realizuara në vitin 2021 (të llogaritura në pajtim me nenin 16 të Ligjit) si vit që i paraprin përqendrimit arrijnë në XXX denarë, gjegjësisht XXX euro.

Në përcaktimin e shumës së gjobës, në pajtim me nenin 64 të Ligjit, KVK merr parasysh peshën e Kundërvajtjes, kohëzgjatjen e Kundërvajtjes dhe shkallën e shtrembërimit të konkurrencës dhe pasojat e shkaktuara nga kundërvajtja.

Gjatë matjes së gjobës KVK merr parasysh rrethanat lehtësuese vijuese:

- Komisioni me vendimin nr. 08-87 të datës 16.07.2025, konstatoi se përqendrimi i theksuar është në përputhje me dispozitat e Ligjit, andaj këtej me zbatimin e përqendrimit nuk është shtrembëruar konkurrenca dhe nuk janë shkaktuar pasoja për konkurrencën në tregun relevant;
- personi fizik Erxhan Sullkoski vullnetarisht e informoi Komisionin për përqendrimin duke parashtruar njoftim për përqendrim nr. 08-87 të datës 16.05.2025, ndërsa të plotësuar më 05.06.2025, 23.06.2025 dhe më 03.07.2025 dhe
- personi fizik Erxhan Sullkoski bashkëpunoi në mënyrë efektive me KVK-në gjatë kohës së procedurës.

Në bazë të asaj që u tha më lart KVK konstatoi se personi fizik Erxhan Sullkoski si person i cili ka fituar kontroll mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup, edhe pse në pajtim me nenin 18 paragrafi (1) të Ligjit nuk guxonte ta zbatonte përqendrimin para datës 16.07.2025, si ditë kur Komisioni solli vendim me të cilin konstatohet se përqendrimi lëndor është në përputhje me Ligjin, personi fizik Erxhan Sullkoski e ka zbatuar përqendrimin më datë 23.08.2022 me parashtrimin e fletëparaqitjes për ndryshim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me çka ka kryer Kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për çka i shqiptohet sanksion - gjobë në shumë prej 2.152.000 denarë që paraqet XXX% të vlerës së të ardhurave të përgjithshme vjetore të personit fizik Erxhan Sullkoski (të llogaritura në pajtim me nenin 16 të Ligjit) të realizuar në vitin 2021 si vit që i paraprin përqendrimit.

Në përputhje me nenin 27 paragrafi (1) të Ligjit për Kundërvajtjet - Nëse kryerësi me një veprim ose me më shumë veprime ka kryer më shumë Kundërvajtje, por nuk është sjellë vendim për Kundërvajtje, paraprakisht do të përcaktohet sanksioni për secilën Kundërvajtje veçmas, ndërsa pastaj do të shqiptohen si sanksion unik të gjitha sanksionet e përcaktuara ashtu.

Në përputhje me nenin 27 paragrafi (2) të Ligjit për Kundërvajtjet - Nëse për më shumë Kundërvajtje të kryera radhazi është përcaktuar gjobë, do të shqiptohet sanksion unik që është

i barabartë me shumën e gjobës së përcaktuar veçmas, e cila nuk mund ta tejkalojë maksimumin ligjor të gjobës të paraparë me ligj.

Prandaj, KVK, në përputhje me nenin 27 të Ligjit për Kundërvajtjet, personit fizik Erxhan Sullkoski i shqipton sanksion unik – gjobë në shumë prej 2.459.000 denarë, që paraqet XXX% të vlerës së të ardhurave të përgjithshme vjetore të personit fizik Erxhan Sullkoski të realizuar në vitin 2021 (në pajtim me nenin 16 të Ligjit) si vit që i paraprin përqendrimit.

Për shkak të të gjitha këtyre që u thanë më lart u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi. Padia e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KOMISIONI PËR VENDIMMARRJE PËR KUNDËRVAJTJTE
KRYETAR
Mr. Борче Размоски**